



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

**Ministria e Tregtisë dhe Industrisë**  
**Ministarstvo Trgovine i Industrije / Ministry of Trade and Industry**

---

Në bazë të, nenit 20, paragrafi tetë (8) të Ligjit Nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike, Këshilli Kombëtar për Zona Ekonomike miraton:

**Rregullore Nr. 01/2013**

**PËR PUNËN E KËSHILLIT PËR ZONAT EKONOMIKE.**

**Neni 1**

**Qëllimi**

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e punës, organizimi dhe fushëveprimi i Këshillit për Zona Ekonomike (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli).

**Neni 2**  
**Përbërja**

1. Përbërja e Këshillit është e përcaktuar me Vendimin e Qeverisë Nr. 03/124 të datës 10.04.2013 si vijon:

- 1.1. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
- 1.2. Ministria e Financave;
- 1.3. Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
- 1.4. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- 1.5. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
- 1.6. Asociacioni i Komunave të Kosovës;
- 1.7. Oda Ekonomike Amerikane;
- 1.8. Aleanca Kosovare e Biznesit;
- 1.9. Oda Ekonomike e Kosovës.

2. Sipas nevojës dhe rrethanave, Këshilli mund të kërkojë informata shtesë dhe ekspertizë prej Institucioneve relevante të Republikës së Kosovës.

### **Neni 3**

#### **Fushë veprimtaria e Këshillit**

Organizon dhe harmonizon aktivitetet e institucioneve shtetërore me qëllim të identifikimit dhe eliminimit të barrierave dhe adresimit të sfidave për krijimin dhe zhvillimin e zonave ekonomike që do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit.

### **Neni 4**

#### **Detyrat e Këshillit**

Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit janë:

1. Propozon politikat dhe harton planin kombëtar për zhvillimin e zonave ekonomike tek Ministri i Tregtisë dhe Industrisë;
2. Këshillon investitorët me qëllim të lehtësimit të marrjes së vendimeve investuese, dhe vendosjen e tyre në zonat ekonomike;
3. Nxit dhe mbështet operatorët dhe shfrytëzuesit për krijimin, zhvillimin dhe funksionimin e zonave ekonomike.

### **Neni 5**

#### **Kryesimi i Këshillit**

1. Këshilli kryesohet nga përfaqësuesi i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në përputhje me Vendimin e Qeverisë Nr. 03/124 të datës 10.04.2013.
2. Në rastet kur mungon përfaqësuesi i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, ai e njofton Këshillin me shkrim për mungesën e tij dhe cakton njërin nga anëtarët e Këshillit për të kryesuar mbledhjen e Këshillit.

### **Neni 6**

#### **Takimet e Këshillit**

1. Këshilli takohet çdo muaj, por mund të takohet edhe më shpesh varësisht nga çështjet e kërkuara për shqyrtim nga përfaqësuesi i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë apo me kërkesën e së paku tre (3) anëtarëve të Këshillit.
2. Kryesuesi i Këshillit thërret dhe kryeson takimet e Këshillit.
3. Ftesa për të marrë pjesë në mbledhje u dërgohet anëtarëve të Këshillit, jo më vonë se pesë (5) ditë para ditës kur duhet të mbahet mbledhja e Këshillit.

4. Rendi i ditës i mbledhjes dhe materialet përgatiten dhe u dërgohen anëtarëve pesë (5) ditë para mbajtjes së mbledhjeve të rregullta.
5. Secili anëtar ka të drejtë që të propozoj futjen e çështjeve të caktuara në rendin e ditës deri në tri (3) ditë para mbajtjes së mbledhjes.
6. Anëtarët e Këshillit janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit. Mos pjesëmarrja në mbledhje duhet të arsyetohet me shkrim tek Kryesuesi i Këshillit.
7. Këshilli ka kuorum kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të Këshillit.
8. E drejta e Votës: vendimet merren me shumicën e votave (një anëtar një votë). Në rast të barazisë së votave, vendos kryesuesi.

#### **Neni 7** **Mbajtja e takimit të Këshillit**

1. Fillimisht bëhet miratimi i rendit të ditës me shumicën e të pranishmëve në takim.
2. Diskutimi hapet pas miratimit të rendit të ditës.
3. Këshilli procedon me mbajtjen e mbledhjes sipas rendit të ditës të miratuar paraprakisht.
4. Propozuesi i pikës së rendit të ditës e cila është në shqyrtim jep arsyetim lidhur me çështjen e paraqitur.
5. Këshilli mund të vendosë për shtyrjen e ndonjë pike të rendit të ditës për mbledhjen tjetër.

#### **Neni 8** **Organizimet e Këshillit**

1. Për të trajtuar tema të veçanta nga fusha e Zonave Ekonomike, Këshilli themelon grupet punuese dhe organizon tryeza të rrumbullakëta.
2. Grupet e punës formohen ad'hoc dhe të njëjtat pushojnë së vepruari pas përfundimit të detyrës për të cilën janë formuar.
3. Drejtues i tryezave të rrumbullakëta apo të grupeve të punës është Ministri i MTI-së.


## **Neni 9 Sekretariati i Këshillit**

1. Punët administrative dhe teknike të Këshillit i kryen Sekretariati i Këshillit.
2. Rolin e Sekretariatit të Këshillit e kryen MTI-ja.
3. Sekretariati i Këshillit shërben për të organizuar, bashkërenduar, zhvilluar dhe mirëmbajtur aktivitetet e nevojshme për punën e Këshillit.
4. Detyrat e Sekretariatit të Këshilli janë:
  - 4.1. Mban procesverbalin nga mbledhjet e Këshillit;
  - 4.2. Bashkërendon punën e hartimit të rekomandimeve, raporteve dhe dokumenteve të tjera të nevojshme;
  - 4.3. Kujdeset për mbajtjen, dërgimin dhe ruajtjen e dokumenteve që dalin nga puna e Këshillit;
  - 4.4. Përgatit mbledhjet e Këshillit;
  - 4.5. Koordinon dhe merr pjesë në mbledhjet e Grupeve Punuese/Koordinuese të Këshillit;
  - 4.6. Ofron mbështetje teknike, logjistike dhe planifikuese për punën e Këshillit dhe të Grupeve Punuese/Koordinuese;
  - 4.7. Sigurohet që të mbledh dhe të shpërndaj të gjitha materialet nga mbledhjet e Këshillit dhe të Grupeve Punuese/Koordinuese;

## **Neni 11 Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Këshillit për Zona Ekonomike.

**Valdrin Lluka**

  
Kryesuesi i Këshillit për Zona Ekonomike  
**Ministria e Tregtisë dhe Industrisë**

Prishtinë, Më 12.08.2013